



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:197055
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05875151

KPPP.nr.1491/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Euro Bllok” SHPK, me NUI:810438623, me seli në Podujevë, rr.”Skenderbeu” të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Valdrin Behrami, me seli në Prishtinë, rr. “Muharrem Fejza” C15/17 nr.5, kundër debitorit “ARSEKO” SHPK, me NUI:810835233, me seli në Prishtinë, rr.”Raif Pollomi” blloku C7 p.n duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.247/23 të datës 30.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 26.06.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “ARSEKO” SHPK, ashtu që Urdhri P.nr.247/23 i datës 30.08.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.247/23 të datës 30.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.196/21 e datës 31.01.2022, faturës nr.209/21 e datës 29.05.2021 dhe faturës nr.20/21 e datës 31.01.2022, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrit, t’ia paguajë kreditorit borxhin 2,867.86 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas tarifës së përmbaruesve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se propozimi për përmbarim është i pabazuar dhe është në kundërshtim me nenin 27, nenin 71 par. 1.6 dhe 1.7 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, debitori konsideron se ky dokument përmbarues si i tillë nuk mund të jetë i përmbarueshëm për faktin se në urdhrin për përmbarim nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit. Tutje debitori thekson se faturat e dorëzuara nga kreditori nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga personi i autorizuar i debitorit, kjo vërtetohet me faktin se në të gjitha faturat e dorëzuara nga kreditori nuk figuron vula e debitorit, por vetëm nënshkrimi e që në rastin konkret nuk dihet se nga kush janë pranuar/nënshkruar këto fatura, për më tepër debitori e ka refuzuar mallin që i ka ofruar kreditori me faturat e lartcekura me arsyen se kreditori nuk i ka bashkangjitur dëshminë e cilësisë së bllokave. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar Prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj në tërësi Urdhrin Përmbarimor P.nr.247/23.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e debitorit se faturat nuk janë nënshkruara nga debitori, një gjë e tillë dëshmohet përmes fletëdërgesave të bashkangjitura në faturë ku figuron nënshkrimi i L.B., ndërsa sa i përket pretendimeve se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara me nenin 27, nenin 71 pika 1.6 dhe 1.7 të LPP-së, kreditori e kundërshton në tërësi sepse dokumenti i besueshëm - fatura e lëshuar i ka përmbushur të gjitha elementet juridike që duhet t’i përmbajë një dokument i përmbarueshëm. Kreditori tutje ka shtuar se debitori asnjëherë nuk ka kërkuar dëshmi për mallin të cilin pretendojnë se e kanë refuzuar. Kreditori ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të vërtetoj Urdhrin Përmbarimor P.nr.247/23 dhe të obligoj debitorin që krahas borxhit kryesor t’i paguaj edhe shpenzimet përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme: faturës nr.196/21 e datës 31.01.2022, faturës nr.209/21 e datës 29.05.2021 dhe faturës nr.20/21 e datës 31.01.2022, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1491/23, me datë 26.06.2024

Gj y q t a r i,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.